

L I G J

Nr.8821, datë 15.10.2001

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE TË EUROCONTROL-IT

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin
e
Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 dhjetorit të vitit 1960 të amenduar nga protokollin shtesë, i nënshkruar në Bruksel, më 6 korrik 1970, i cili është amenduar nga protokollin i 21 nëntorit të vitit 1978, të gjitha këto të amenduara nga protokollin i nënshkruar në Bruksel, më 12 shkurt 1981.

Neni 2

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen shumëpalëshe për pagesat e rrugës, e 12 shkurtit të 1981.

Neni 3

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin që konsolidon Konventën Ndërkombëtare të EUROCONTROL-it dhe amendamentet e saj, hapur për nënshkrim në Bruksel, më 27 qershor 1997.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3122, date 22.10.2001 te Presidentit te Republikes se Shqiperise
Rexhep Meidani